



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Durrës, më 24.04.2025

**NJOFTIM PËR RENDIN E DITËS**  
**Mbledhje e Radhës**

Në mbështetje të nenit 17, nenit 53, pika 2, të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 48, nenit 49 të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, Këshilli Bashkiak Durrës,

**NJOFTON:**

DITËN E MËRKURË, DATË 30.04.2025, ORA 12:00, KËSHILLI DO TË MBAJË NJË MBLEDHJE TË RADHËS, NË SALLËN E KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS, ME KËTË REND DITE:

****	MIRATIMI I RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN MARS 2025
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2025

Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NORMAVE TË FURNIZIMIT ME UNIFORMË TË PUNONJËSVE TË POLICISË BASHKIAKE
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR VAZHDIMIN E PROCEDURËS SË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË PËRDORIMIT TË SIPËRFAQES PYJORE NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR, NË ZBATIM TË VENDIMIT NR.37, DATË 01.08.2023 TË KKT-SË “PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN RESORT TURISTIK LURA 5, FAZA 3, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA DURRËS”
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E RAPORTIT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2024
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN PRILL 2025
Pika 7. <i>Informim Këshilltarëve</i>	INFORMACION NGA QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT MBI PROÇEDURËN E DALJES JASHTË PËRDORIMIT / TJETËRSIMIT TË AKTIVEVE TË PANEVOJSHME.
*****	DISKUTIME DHE PYETJE NGA KOMUNITETI

Komisionet, që do të shqyrtojnë projektvendimin do të jenë:

Në mbështetje të nenit 33, nenit 34 pika 1, nenit 77 pika 8, të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, anëtarët e Komisioneve të Këshillit Bashkiak pasi shqyrtojnë me njëri tjetrin projektvendimin përkatës, dorëzojnë propozimin e tyre (Raportin) mbi projektvendimin pranë zyrës së Sekretarit të Këshillit, sipas grafikut të mëposhtëm.

**Datë 29.04.2025**

Nr.	Komisionet që shqyrtojnë projektvendimet	Projektvendime pikat e rendit të ditës	Vendi i mbajtjes së mbledhjes	Ora
1.	Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike	2, 3, 4, 5	Salla e Këshillit Bashkiak	10.00

<b>2.</b>	Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave- Tarifave	<b>5</b>	Salla e Këshillit Bashkiak	<b>11.00</b>
<b>3.</b>	Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës,	<b>4</b>	Salla e Këshillit Bashkiak	<b>12.00</b>
<b>4.</b>	Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë	<b>2, 3</b>	Salla e Këshillit Bashkiak	<b>13.00</b>
<b>5.</b>	Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit	<b>1, 6</b>	Zyra e Sekretarit të Këshillit	<b>14.00</b>

**Pika 7.** Relatohet në seancë plenare nga Drejtoresha e Qendrës Ekonomike të Arsimit .

## **SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS**

**Dorina Milja**